

BACHELOR NË “KOMUNIKIM”

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Ky program synon të pajisë studentët me njohuritë dhe kompetencat kryesore në studimet e komunikimit, teoritë dhe praktikën që lidhen me studimin e medias dhe marrëdhënieve publike. Studentët aftësohen të analizojnë në mënyrë kritike pushtetin dhe praktikën e medias, qëndrimet etike dhe kulturore që lidhen me praktikën bashkëkohore të komunikimit në shoqëri, dhe të demonstrojnë njohuri të thella të marrëdhënieve publike ose gazetarisë, medias digjitale, marketingut dhe reklamës.

REZULTATET E TË NXËNIT

Në përfundimin me sukses të këtij programi, studenti do të jetë i aftë:

- Të njohë bazat konceptuale të disiplinës me implikime teorike, kritike dhe etike.
- Të përdorë informacionin dhe kërkimin metodologjik në studimin e komunikimit.
- Të aplikojë bazat dhe metodat e komunikimit në kontekste të aplikuara profesionalisht.
- Të demonstrojë kompetencë në aktivitetet e komunikimit të aplikuara duke projektuar dhe kryer aktivitete komunikimi dhe shkrime akademike.
- Të përgatisë prezantime efektive gojore për një sërë temash në mjedise publike.
- Të krijojë mesazhe të përshtatshme për audiencën, qëllimin dhe kontekstin, dhe t'i analizojë ato.
- Të kuptojë dhe analizojë diskursin publik.

PROFILI: GAZETARI

- Të kryejë hulumtime dhe intervista gazetareske.
- Të përgatisë përmbajtje për mediat e lajmet.
- Të përdorë teknologjinë e përshtatshme për mediumin.
- Të hartojë një shumëllojshmëri të përmbajtjeve së medias, duke përfshirë lajme, njoftime për shtyp dhe shkrime reklamash, duke ndjekur praktikën dhe standardet kontekstuale gazetareske.

PROFILI: MARRËDHËNIE PUBLIKE

- Të kuptojë disiplinën e marrëdhënieve publike dhe çështjet e saj kryesore.
- Të krijojë dhe analizojë përmbajtje të përshtatshme për audiencën, qëllimin dhe kontekstin.
- Të hartojë një shumëllojshmëri të përmbajtjeve të medias, duke përfshirë lajme, njoftime për shtyp dhe shkrime reklamash, duke ndjekur praktikën dhe standardet kontekstuale gazetareske.

PROFILI: MARKETING

- Të kuptojë një kompani dhe aktivitetet e saj të komunikimit të marketingut.
- Të përdorë një sërë mediash dhe metodash në dispozicion të marketuesve.
- Të demonstrojë një kuptim gjithëpërfshirës të teorive dhe koncepteve të komunikimit të marketingut.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Të diplomuarit në këtë program studimit kanë mundësi të punësohen si:

- Specialist komunikimi në institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Specialist komunikimi në organizata joqeveritare.
- Zëdhënës ose konsulent për komunikimin dhe marrëdhëniet me publikun.
- Specialist i Marrëdhënieve me Publikun.
- Gazetar/ reporter në mediat e shkruara dhe digjitale, televizion, radio, etj.
- Organizues/ menaxher aktiviteteve.
- Ekspert komunikimi në media.
- Analist i çështjeve të komunikimit dhe marrëdhënieve publike.
- Analist i çështjeve të medias.
- Analist i çështjeve të marketingut.
- Specialist marketingu në kompani private biznesi.
- Hulumtues në fushën e studimit të komunikimit.
- Hartues dhe koordinator projekteve.
- Konsulent i komunikimit pranë institucioneve shtetërore dhe në organizatat joqeveritare.
- Moderator në media audiovizive, podcast, etj.



BACHELOR "KOMUNIKIM" 180 ECTS

Nr.	Viti	Sem	Emri i lëndës	ECTS
-----	------	-----	---------------	------

A - LËNDË BAZË/ 15% - 20%/ 32 ECTS

1	I	1	Hyrje në filozofi	6
2	I	1	Hyrje në sociologji	6
3	II	1	Hyrje në psikologji	6
4	I	2	Shkrim akademik dhe Metoda Kërkimi	8
5	II	1	Hyrje në ekonomi	6
				32

B - LËNDË KARAKTERIZUESE/ 50% - 55%/ 97 ECTS

1	I	1	Hyrje në komunikim	6
2	III	1	Komunikim ndërkulturor	6
3	II	2	Teoritë e komunikimit	8
4	I	2	Histori Arti dhe Komunikim Pamor	10
5	I	1	Gjuhë shqipe	8
6	II	1	Marrëdhënie publike	8
7	I	2	E folura në publik	6
8	I	2	Hyrje në shkenca politike	8
9	III	1	Bazat e semiotikës	6
10	II	2	Hyrje në analizë ligjërimit	5
11	III	2	Estetikë	6
12	II	1	Bazat e marketingut	6
13	III	1	Komunikim politik	8
14	III	2	Komunikim organizativ	6
				97

C - LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE/ 12% - 15%/ 24 ECTS

PROFIL I:			MARRËDHËNIE PUBLIKE	
1	II	2	Praktikum i Marrëdhënieve Publike	6
2	III	1	Etikë	6
3	III	1	Reklama	6
4	II	2	Shkrim Editim Informacioni	6
PROFIL II:			GAZETARI	
1	II	2	Shkrim Editim Informacioni	6
2	III	1	Bazat e Multimedias	6
3	III	1	Teknikat e skenarit	6
4	II	2	Fotografia	6
PROFIL IV:			MARKETING	
1	III	1	E- shërbimet	6
2	II	2	Parimet e kërkimit të tregut	6
3	III	1	Parimet e shpërndarjes dhe shitjes	6
4	II	2	Sjellje konsumatore	6
				24

D - LËNDË PLOTËSUESE/ 10% - 15%/ 18 ECTS

1	II	1	Anglisht	5
2	I	1	Bazat e informatikës	4
3	II	2	Hartim dhe menaxhim projektsh	6
4	II	2	Statistikë	6
5	II	2	Historia Bashkëkohore	6
6	III	2	Praktikë dhe zhvillim karriere	5
				20

E - DETYRIME PËRMBYLLËSE/ 3% - 5%/ 7 ECTS

1	III	2	Punimi i diplomës/ Provimi Përgjithshëm Përfundimtar	7
---	-----	---	--	---